

**VENDIM**  
**Nr. 245, datë 2.6.2022**

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME**  
**Vlorë SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 2.6.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.’”,

**VËREN SE:**

1. Ujësjellës-Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. 941 prot., datë 19.4.2022, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së, për rinovim licence të shoqërisë për kategorinë A të shërbimit – grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik dhe kategorinë C të shërbimit – largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Vlorë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Vlorë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 166 045 banorë të Bashkisë Vlorë;

b) Drejtuesi ligjor, znj. Entela Hodaj, është diplomuar në Universitetin Teknologjik “Ismail Qemal Vlorë”, dega Biznes, profili Marketing në vitin 2007;

c) Drejtuesi teknik, z. Kastriot Memaj, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega Inxhinieri Mekanike për Impiante, në vitin 1991 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht, në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Vlorë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a., me (NUIS K07303204A), në kategoritë:

a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) Drejtuese ligjore – Elona Hodaj;

b) Drejtues teknik – Kastriot Memaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. është Bashkia Vlorë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**